

UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS



Misioni i 21-të BOKU vjen në UBT

Misioni i radhës përfshiu mbledhjen e Komitetit Drejtues, diskutime për finalizimin e programeve Master, si dhe një sesion të zgjeruar pune me koordinatorët e programeve të ristrukturuara.

Lexo në faqen 3

UBT organizon konferencën ndërkombëtare CASEE

Konferenca mbledhi ekspertë, akademikë dhe përfaqësues institucionesh nga 14 vende të ndryshme të Europës dhe më gjerë, ku u diskutua mbi integrimin europian, reformat në bujqësi, menaxhimin e ujërave dhe të ardhmen e arsimit të lartë.

Një pjesë e rëndësishme e diskutimeve iu kushtua edhe projektit UBT2030 dhe transformimit të Universitetit Bujqësor të Tiranës drejt standardeve më të avancuara europiane. **Lexo në faqen pasardhëse...**

Tre ditët e CASEE në UBT



Konferenca e 16-të Ndërkombëtare CASEE çeli siparin me ditën e saj të parë në Tiranë, një nga aktivitetet më të rëndësishme akademike në rajon në fushën e bujqësisë, mjedisit dhe shkencave të jetës.

Konferenca mbledhi ekspertë, akademikë dhe përfaqësues institucionesh nga vende të ndryshme të Europës dhe më gjerë, ku u diskutua mbi integrimin evropian, reformat në bujqësi, menaxhimin e ujërave dhe të ardhmen e arsimit të lartë.

Një pjesë e rëndësishme e diskutimeve iu kushtua edhe projektit UBT2030 dhe transformimit të Universitetit Bujqësor të Tiranës drejt standardeve më të avancuara evropiane. **Lexo më shumë...**



Dita e dytë e konferencës ndërkombëtare CASEE 2026 në Universitetin Bujqësor të Tiranës u fokusua tek prezantimi i reformës strategjike UBT2030, një nga proceset më ambicioze të transformimit në arsimin e lartë në Shqipëri. Profesorë dhe studiues nga universitete evropiane diskutuan gjithashtu mbi bujqësinë precize, sigurinë ushqimore, ndryshimet klimatike, teknologjitë digjitale dhe inovacionin në shkencat e jetës.

Konferenca u mbyll me sesionin e posterave shkencorë, ku pjesëmarrës nga Shqipëria dhe Europa prezantuan kërkimet e tyre në bujqësi, mjedis dhe zhvillim rural. **Lexo më shumë...**



Nga peizazhet karakteristike të Beratit, tek momentet e bukura së bashku dhe shija autentike e verës shqiptare në një kantinë tradicionale. Pjesëmarrësit e CASEE 2026 patën mundësinë të përjetojnë nga afër kulturën, mikpritjen dhe traditën shqiptare, në një udhëtim që bashkoi akademinë me eksperiencën autentike lokale.

Berati, me historinë dhe natyrën e tij unike, ofroi një atmosferë të veçantë për networking dhe kujtime të paharrueshme.

Shiko videon për më shumë...



UBT-BOKU, Misioni i 21-të në Tiranë

Misioni i radhës nisi me mbledhjen e Komitetit Drejtues ku morën pjesë Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku, Rektorja e BOKU University, Prof. Dr. Eva Schulev-Steindl, drejtues akademike të universitetit, përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, përfaqësues të ADA-s, si dhe ekipi i BOKU i udhëhequr nga Prof. Dr. Hubert Hasenauer.

Një takim po ashtu shumë i rëndësishëm u mbajt edhe për finalizimin e programeve të doktoraturës, me pjesëmarrjen e Prof. Dr. Erinda Lika- Zv/Rektore për Shkencën dhe Projektet, Prof. Dr. Hubert Hasenauer dhe Matthias Schreiner, BOKU.

Në vijim një sesion i zgjeruar punë për mbështetjen e zbatimit të programeve të reja, ku morën pjesë koordinatorët e të gjitha programeve Bachelor dhe Master të ristrukturuara. Diskutimet u përqendruan në organizimin e zbatimit të programeve, rolin e koordinatorëve, afatet kohore dhe mbështetjen e nevojshme për të garantuar një nisje sa më të suksesshme të vitit të ri akademik.

Sesioni u hap nga Prof. Dr. Hubert Hasenauer, Prof. Dr. Ilir Kapaj- Zv/Rektor për Mësimin dhe Prof. Assoc. Romina Koto- Zv/Rektore për Marrëdhëniet me Institucionet dhe Publikun, të cilët theksuan rëndësinë e kalimit nga faza e hartimit të programeve drejt zbatimit konkret të tyre në auditor, përmes një filozofie moderne të mësimdhënies dhe menaxhimit akademik. **Lexo më shumë...**





Dy vjet marrëveshje strategjike UBT-BOKU

Dy vite më parë, UBT nisi një rrugëtim transformimi pas nënshkrimit të marrëveshjes strategjike me Universitetin BOKU të Vjenës. Sot, me krenari shohim arritjet e deritanishme dhe me vendosmëri vazhdojmë drejt objektivave të reja. Ky partneritet, i realizuar falë përkushtimit të stafit të UBT-së dhe kolegëve nga BOKU Vienna, nën drejtimin e Prof. Hubert Hasenauer, është shndërruar në një gur themeli të modernizimit akademik dhe rinovimit institucional. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar mbi 21 misione të strukturuar, si dhe dhjetëra takime, workshop-e, analiza dhe konsultime, të cilat kanë mundur ridizajnimin e ofertës akademike të UBT-së.

Ky rrugëtim përfaqëson angazhimin e UBT-së për të përfaqësuar ndryshimin, për t'iu përgjigjur sfidave të kohës dhe për t'u harmonizuar me aspiratat e Shqipërisë drejt Bashkimit Europian 2030. Shprehim mirënjohje për çdo koleg dhe partner që ka kontribuar në këtë transformim, veçanërisht për ekipin e BOKU Vienna dhe Prof. Hubert Hasenauer për udhëheqjen e tij të vyer. Falënderojmë gjithashtu Qeverinë e Shqipërisë dhe Qeverinë e Austrisë për mbështetjen strategjike në këtë projekt pionier për arsimin e lartë në Shqipëri. Një moment i rëndësishëm i këtij transformimi mbetet modernizimi i Fakultetit të Mjekësisë Veterinare, në përputhje me modelin e Vetmeduni Vienna dhe standardet e EAEVE, nën udhëheqjen e Prof. Petra Winter.

Lexo më shumë...



UBT marrëveshje me universitete italiane dhe hungareze



Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe Universiteti i Perugias në Itali kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, duke forcuar më tej rrjetin akademik ndërkombëtar të UBT-së. Një delegacion i Universitetit të Perugias ishte në Tiranë në kuadër të projektit "TNE Health Connect", me fokus në edukimin, rrjetëzimin dhe bashkëpunimin akademik ndërkombëtar. Përfaqësuesit italianë morën pjesë gjithashtu edhe në aktivitetet e konferencës ndërkombëtare CASEE 2026, të organizuar nga UBT. **Lexo më shumë...**



Universiteti Bujqësor i Tiranës ka zgjeruar rrjetin e bashkëpunimeve ndërkombëtare duke nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me Hungarian University of Agriculture and Life Sciences (MATE), një nga institucionet më të rëndësishme akademike në Hungari në fushën e bujqësisë, shkencave të jetës dhe kërkimit shkencor. Marrëveshja u firmos në Tiranë nga Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku dhe Rektori i MATE, Prof. Dr. Csaba Gyuricza, me synimin për të forcuar bashkëpunimin akademik, kërkimor dhe institucional. **Lexo më shumë...**





Studentja italiane që studion Mjekësi Veterinare në UBT “UBT Talk Podcast”

Në episodin e radhës të “UBT Talk” njihuni me historinë e Xhulia Grekos, studentes nga Italia që zgjodhi të ndjekë studimet në Mjekësi Veterinare në Universitetin Bujqësor të Tiranës.

Në këtë bisedë, Xhulia tregon çfarë e motivoi të vinte për të studiuar në Shqipëri, lidhjen e veçantë që ka krijuar me vendin tonë dhe eksperiencën e saj në muajt e parë të jetës studentore në Tiranë. Ajo ndan gjithashtu përshtypjet për Shqipërinë, mikpritjen, UBT-në dhe sfidat e një aventure të re akademike jashtë vendit të saj. **Shiko videon e plotë...**






UBT nderon gazetaren Edlira Birko dhe Prof. Dr. Flutura Kalemin

Ishte një kënaqësi e veçantë për Universitetin Bujqësor të Tiranës të nderonte dy personalitete të spikatura, të cilat përmes punës, përkushtimit dhe profesionalizmit të tyre kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në jetën akademike, mediatike dhe shoqërore të vendit. Në një ceremoni të posaçme me pjesëmarrjen e Senatit Akademik, UBT i akordoi Certifikatën e Mirënjohjes gazetares dhe studiueses së njohur Edlira Birko, ndërsa Prof. Dr. Flutura Kalemi u nderua me titullin e lartë “Profesor Emeritus”.

Ceremonia u hap nga Zv/Rektorja për Shkencën dhe Projektet, Prof. Dr. Erinda Lika, e cila prezantoi figurën dhe veprimtarinë e znj. Edlira Birko, duke vlerësuar kontributin e saj shumëvjeçar në gazetarinë shqiptare dhe veçanërisht rolin e saj në promovimin e arsimit, shkencës dhe dijes përmes mediave publike. Ajo theksoi se gjatë karrierës së saj, Edlira Birko ka dëshmuar profesionalizëm, integritet dhe përkushtim të vazhdueshëm ndaj informimit cilësor dhe edukimit të publikut.

Në vijim, Rektori i Universitetit Bujqësor të Tiranës, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku vlerësoi kontributin e dy zonjave të nderuara nga universiteti. Ai theksoi se UBT ka pasur privilegjin të bashkëpunojë ndër vite me znj. Edlira Birko, e cila përmes emisionit “Auditor Arsimi” në RTSH, që drejton prej më shumë se 20 vitesh, ka promovuar në mënyrë të vazhdueshme arsimin e lartë, kërkimin shkencor dhe arritjet e universiteteve shqiptare. **Lexo më shumë...**





Simpozium kombëtar për bletët në UBT

Aktiviteti u organizua nga Fakulteti i Mjekësisë Veterinare në Universitetin Bujqësor të Tiranës, në kuadër të programit READ. Një prezencë të konsiderueshme në aktivitet patën bletarë nga Shqipëria dhe Kosova, të cilët morën pjesë në diskutime duke e kthyer simpoziumin në një platformë bashkëpunimi dhe shkëmbimi eksperiencash për sektorin.


Pjesë e aktivitetit ishin edhe prezantime studentore si dhe workshop-i i aplikuar mbi praktikën e sigurta në bletari dhe reduktimin e rrezikut nga pesticidet.

Lexo më shumë...




Profesorë e studentë ndërkombëtarë në UBT

Universiteti Bujqësor i Tiranës pati kënaqësinë të mirëpriste Prof. Dr. Franz Ottner nga Universiteti i Burimeve Natyrore dhe Shkencave të Jetës (BOKU). Leksionet u fokusuan në tema që lidhen me Gjeologjinë e Përgjithshme, Mineralogjinë, Shkencën e Tokës, Rehabilitimin e Tokës dhe Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë. **Lexo më shumë...**



Ndërkohë një grup prej 30 studentësh nga Bygholm Landbrugsskole në Danimarkë, të profilizuar në degën e Bujqësisë, zhvilluan një vizitë studimore në UBT. Gjatë vizitës së tyre në kampusin universitar, studentët patën mundësinë të njihen nga afër me ambientet e UBT-së, duke përfshirë laboratorët e bimëve dhe të tokës. **Lexo më shumë...**



UBT pjesë e "Open Day" në Shkollën Profesionale "Rakip Kryeziu" në Fier



Universiteti Bujqësor i Tiranës mori pjesë në aktivitetin "Open Day" të organizuar nga Shkolla e Mesme Profesionale "Rakip Kryeziu" në Fier, një institucion i njohur i arsimit profesional me profil bujqësor dhe veterinar.

UBT u përfaqësua në këtë aktivitet nga Dekani i Fakultetit të Mjekësisë Veterinare, Prof. Dr. Rezart Postoli, si dhe Drejtoresha e Marrëdhënieve me Publikun, Besmira Pelushaj, të cilët prezantuan risitë që universiteti po zbaton në kuadër të reformës UBT2030. Gjatë aktivitetit, drejtori i shkollës, Alket Merdanaj, u bëri të pranishmëve një tur në ambientet dhe laboratorët e shkollës. **Lexo më shumë...**



Maturantë nga Cërriku vizitojnë UBT



Një grup maturantësh nga Shkolla e Mesme Profesionale Bujqësore "Mihal Shahini" në Cërrik zhvilluan një vizitë informuese në Universitetin Bujqësor të Tiranës, me qëllim njohjen nga afër me ofertën akademike dhe jetën universitare.

Gjatë vizitës, nxënësit u njohën me programet e studimit që ofron UBT, duke marrë informacion të detajuar mbi degët bachelor dhe mundësitë që ato ofrojnë për zhvillimin profesional në fushat e bujqësisë, mjedisit dhe shkencave të jetës. Ata patën gjithashtu mundësinë të vizitojnë ambientet universitare, auditorët, laboratorët modernë, si dhe konviktet, duke krijuar një panoramë të plotë mbi kushtet e studimit dhe jetesës në kampus. **Lexo më shumë...**

